



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MIEDITË, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ZHVITINE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jediniça Org.Unit	101
Nr i Faqeve Br. Stranica No. Pages	- 04 -
Nr i Prot. Broj Prot. Prot.No	2159-2/22
Data: Datum: Date:	21.04.22
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Inspektorati i MMPHI-së / Inspektorat MSPPI/ Inspectorate of MESPI

DATE / A:	14.04.2022
REFERENCË:	Nr. 022/INS-RR-17-P-06; dt. 13.04.2022,
PËR/ZA/TO:	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Prishtinë
CC:	- Liburn Aliu - Ministër i MMPHI-së - Punëkryesit "H & B Consulting" sg.p.k, Rr."Mehmet Gradica" Obj. 7 ; Nr.2-Bregu i Diellit, Prishtinë - Kompania " Alb -Architect " sh.p.k-Rr. " Isa Kastrati " Nr.1, Prishtinë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Izedin Bytyqi - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Refik Rexhepaj, Inspektor i Planifikimit dhe Ndërtimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të punimeve ndërtimore ndaj investitorit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit .

Të nderuar,

Bashkangjitur do të gjeni Vendimin, bazuar në inspektimin e zhvilluar, me Nr.022/INS-RR-17-P-06; dt.12.04.2022, ndaj objektit Stadiumi i Qytetit të Mitrovicës së Jugut " Adem Jashari " , për arsye të fillimit të punimeve ndërtimore pa Leje ndërtimore.

Me respekt!

Faqe 2 nga 5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planing and Infrastrukture

Inspektorati i MMPHI-së / Inspektorat MSPPI/Inspectorate of MESPI

Në bazë të Ligjit për Ndërtim nr.04/L-110 sipas nenit 29 dhe 30; Udhëzimit Administrativ Nr.05/2017 nenit 15 dhe Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit sipas neni 13, 22, 39 dhe neni 40, Inspektorati i Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, nxjerrë këtë :

Vendim

Urdhërohet investitori - Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit , që:

1. Menjëherë ti ndërpresë të gjitha aktivitetet ndërtimore në Objektivin e Stadiumit të Qytetit " Adem Jashari " në Mitrovicën e Jugut .
2. Në afat prej 30 ditësh të aplikoj pranë organit kompetent të MMPHI-së për tu pajisur me leje ndërtimore për Objektivin Stadiumi i Qytetit " Adem Jashari " në Mitrovicën e Jugut.
3. Për moszbatim të urdhëresës së dhënë Inspektorati i MMPHI-së do të merr masa bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Faqe 3 nga 5

Arsyetim

Inspektorati i MMPHI-së ka zhvilluar vizitën inspektuese me dt.12.04.2022 në objektin e Stadiumit të qytetit " Adem Jashari " në Mitrovicën e Jugut . Me rastin e inspektimit kemi konstatuar se punëkryesi Kompania " H & B Consulting " sh.p.k ka filluar aktivitete ndërtimore në rindërtimin dhe renovimin e objektit të Stadiumit të qytetit " Adem Jashari " në Mitrovicën e Jugut me investitor nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit pa u pajisur me leje ndërtimore

Inspektorati i MMPHI-së me rastin e inspektimit në lokacion me dt.12.04.2022 me procesverbal Nr. 022/INS-RR-17-P-06; dt.12.04.2022, kemi konstatuar se Punëkryesi " H & B Consulting " sh.p.k , ka filluar aktivitete ndërtimore në rindërtimin dhe renovimin e Stadiumit të Qytetit " Adem Jashari " në Mitrovicën e Jugut duke u bazuar në dokumentacionin teknik , projektin kryesor por të pa aprovuar nga organi kompetent i MMPHI-së dhe pa u pajisur me leje ndërtimore . Bazuar në dokumentacionin teknik por të pa aprovuar nga organi kompetent , kapacitetit i Stadiumit parashihet të jetë për 13740 ulëse , ku me ç 'rast si i tillë i takon objekteve të Kat.III dhe kompetent për lëshimin e lejeve ndërtimore është MMPHI-së. Inspektorati i MMPHI-së me procesverbal kemi urdhëruar investitorin , respektivisht Punëkryesin " H & B Consulting " sh.p.k që menjëherë ti ndërpres punët ndërtimore deri në pajisjen me lejen ndërtimore dhe për objektin e lartcekur të aplikoj për Leje ndërtimore në organin kompetent të MMPHI-ë , pasi që objekti i Stadiumit është në Kat. e III-të të ndërtimit.

Sipas Ligjit të Ndërtimit Nr.04/L-110 nenit 19 pika 1, Ministria ka kompetencë për lëshimin e lejeve ndërtimore për objektet e kategorisë III , sipas Shtojcës Nr.1 të këtij ligji . Në Shtojcën Nr.1 , nenin 1 pika 1.5 theksohet se Stadiumeve për dhjetëmijë (10.000) e më shume spektator dhe pasi që Rindërtimi i Stadiumit parashihet të jetë 13740 ulëse , kompetent për lëshimin e lejes ndërtimore është organi kompetent i MMPHI-së . Në bazë të Ligjit të Ndërtimit Nr.04/L-110 nenit 14 pika 1.2 dhe 1.4 , theksohet se Lejet ndërtimore lëshohen për Rindërtimin e objekteve ekzistuese, riparimin ne eobjekteve ndërtimore , nëse ndodh ndryshime thelësore, prandaj Objekti i Stadiumit të Qytetit " Adem Jashari " duhet të pajiset me lejen ndërtimore nga organi kompetent i MMPHI-së sipas Ligjit të Ndërtimit Nr.04/L-110.

Nga faktet e lartcekura konstatojmë se investitori , respektivisht punëkryesi kanë bërë shkelje të Ligjit të Ndërtimit Nr.04/L-110 nenit14, 19,24 ,dhe 26 dhe nenit 15 pika 1.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2017, të fillimit të punimeve pa u pajisur me lejen ndërtimore.

Inspektorati i MMPHI-së, duke u bazuar nga konstatimet e lartcekura urdhëron Investitorin Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sportit që të zbatojnë urdhëresën e lartcekur sipas diapozitivit të këtij Vendimi, në të kundërtën do të merr masa sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë në afat prej 8 ditësh në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në MMPHI-së, nga dita e pranimt të këtij Vendimi.

Ti dërgohet :

- Palës, Minisris së Kulturës , Rinis dhe Sportit
- Punëkryesit "H \$ B Conculing" sh.p.k
- Org. Mbikëqyrës " Alb- Architect " sh.p.k
- Ministrit të MMPHI-së
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm
- Arkivit



Faqe 5 nga 5

A

115

SD



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	115
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	15
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	2159/22
Data: Datum: Date:	14.04.22
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planing and Infrastrukture

Prishtinë, datë, 14.04.2022

Për miratim: Izedin Bytyqi , Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI-së

Lënda: Vendim për ndërprerje të punimeve ndërtimore ndaj investitorit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit .

Hartuar nga:
Insp. Refik Rexhepaj

Faqe 1 nga 5

Adresa: ish pallati i mediave " Rilindja" kati 15, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 200 33 208;
<http://www.mea-ks.net>